



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

338/20

27.07.20

Data/Datum:

PRISHTINE

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr .338/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Ardi CC” L.L.C. Prishtinë , kundër Ri Njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit të datës :12.05.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Konkurs projektimi për hartimin e Projektit Konservimi dhe adaptimi i ndërtesës së ish- Kadastrit- Prishtinë ”, me nr. të prokurimit: 616-19-5638-4-2-3 , të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë (KK.P), më datën: 08.07.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Ardi CC” L.L.C. Prishtinë , kundër Ri Njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit të datës :12.05.2020 -Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: “ Konkurs projektimi për hartimin e projektit Konservimi dhe adaptimi i ndërtesës së ish- Kadastrit- Prishtinë ”, me nr. të prokurimit: 616-19-5638-4-2-3 , të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Prishtinë ” (KK.P),

II. VËRTETOHET, Ri Njoftimi i rezultatet e konkursit të projektimit i datës :12.05.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “ Konkurs projektimi për hartimin e projektit Konservimi dhe adaptimi i ndërtesës së ish- Kadastrit- Prishtinë ”, me nr. të prokurimit: 616-19-5638-4-2-3 , të iniciuar nga AK-KK Prishtinë

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konfirmon dispozitat ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Ardi CC” L.L.C. Prishtinë , aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Ardi CC” L.L.C. Prishtinë , si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 29.05.2020 me nr. 338/20, kundër Ri Njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit të datës :12.05.2020- Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: “Konkurs projektimi për hartimin e projektit Konservimi dhe adaptimi i ndërtesës së ish-Kadastrit-Prishtinë ”, me nr. të prokurimit: 616-19-5638-4-2-3 , të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Prishtinë ” (KK.P). duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7 ,52 , 54, 56 ,2, 2.1 ,59, si dhe neni 78 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.06.2020, ka autorizuar ekspertin profesional-shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional-shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 22.06.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “Ardi CC” L.L.C

PRETENDIMI NR.1, Lidhur me pretendimin e OE ”Ardi CC L.L.C. shifra 5044. –ankues se:“...projekti i vlerësuar më së shumti pikë ka mungesa të detajeve arkitektonike dhe të enterierit...” (shifra 8401), në bazë të Vendimit të shqyrtimit të kërkesës të Autoritetit Kontraktues të datës 04.10.2019”

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.1, Eksperti shqyrtues gjatë analizës së detyrës projektuese , projektit të propozuar, Raportit të Vlerësimit të tenderëve dhe ligjit për Trashëgimin Kulturorë konstaton se operatori ekonomik shifra 8401 ka përmbushur në masë të madhe kërkesat e kërkuara sipas detyrës

projektuese me disa pjesë të detajeve të pa plotësuar (të cilat nuk i mundëson Projekti Ideor), por të cilat me rastin e punimit të Projektit Kryesor ka mundësi të korrigojen dhe plotësohen brenda mundësive të cilat lejon arkitektura dhe konstruksioni i ish objektit të kadastrit pasi që për shkak të vjetërsisë së objektit dhe materialeve ndërtimore me të cilat është i punuar ky objekt këto ndërhyrje janë të kufizuara. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

PRETENDIMI NR.2, Lidhur me pretendimin e OE "Ardi CC L.L.C. shifra 5044. –ankues se për shkak të shkeljeve esenciale të LPP-së, të anulohet në tërësi këtë procedurë prokurimi, pasi që i ka humbur seriozitetin vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit dhe kjo si rezultat i asaj që komisioni vlerësues jep vlerësim të ndryshëm në 3 vlerësimet e bëra për projektet e njëjta

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.2, Eksperti Shqyrtues gjatë analizës së dokumentacionit të ofruar, projekteve ideore, raportit të vlerësimit konstaton se nuk ka arsye të anulohet kjo procedurë e prokurimit sipas pretendimit të operatorit ekonomik ankues, pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nga komisioni është konstatuar se ka operator ekonomik të cilët janë të përgjegjshëm. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues : Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet Vendimi mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që Autoriteti Kontraktues të vazhdojë me procedurat e prokurimit.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 22.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 23.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 08.07.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit,

ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrirat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e OE "Ardi CC L.L.C. shifra 5044. –ankues se: "...projekti i vlerësuar më së shumti pikë ka mungesa të detajeve arkitektonike dhe të enterierit..." (shifra 8401), në bazë të Vendimit të shqyrtimit të kërkesës të Autoritetit Kontraktues të datës 04.10.2019"

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues / teknik sqaron se gjatë analizës së detyrës projektuese, projektit të propozuar, Raportit të Vlerësimit të tenderëve dhe ligjit për Trashëgimin Kulturor konstaton se operatori ekonomik shifra 8401 ka përmbushur në masë të madhe kërkesat e kërkuara sipas detyrës projektuese me disa pjesë të detajeve të pa plotësuar (të cilat nuk i mundëson Projekti Ideor), por të cilat me rastin e punimit të Projektit Kryesor ka mundësi të korrigjohen dhe plotësohen brenda mundësive të cilat lejon arkitektura dhe konstruksioni i ish objektit të kadastrit pasi që për shkak të vjetërsisë së objektit dhe materialeve ndërtimore me të cilat është i punuar ky objekt këto ndërhyrje janë të kufizuara, andaj nga ky fakt konstatojmë se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE "Ardi CC L.L.C. shifra 5044. –ankues se për shkak të shkeljeve esenciale të LPP-së, të anulohet në tërësi këtë procedurë prokurimi, pasi që i ka humbur serioziteti vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit dhe kjo si rezultat i asaj që komisioni vlerësues jep vlerësim të ndryshëm në 3 vlerësimet e bëra për projektet e njëjta

Paneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues/teknik sqaron, se gjatë analizës së dokumentacionit të ofruar, projekteve ideore, raportit të vlerësimit konstaton se nuk ka arsye të anulohet kjo procedurë e prokurimit sipas pretendimit të operatorit ekonomik ankues, pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nga komisioni është konstatuar se ka operator ekonomik të cilët janë të përgjegjshëm, andaj konstatojmë se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në të cekurat si më lart konstaton komisioni i vlerësimit, vlerësimin e ka kryer në pajtim me nenin 80 të LPP-së dhe neni 57 i RRUOPP, andaj vijmë në përfundim se ankesa e OE

ankues duhet të refuzohet dhe AK të vazhdoj me procedurat e mëtutjeshme lidhur me aktivitetin e prokurimit ne fjalë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi Panelit Shqyrtues
Nuhî Paçarizi



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - KK Prishtinë (KK.P),

1x1 OE - "Ardi CC" L.L.C. Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.